



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË
DEGA VENDORE TIRANË

NOTER PERIAN B. BODINAKU
ADRESA Ç. TOPULLI
TEL: 674010104

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 152

Nr. koleksioni: 34

Tirane më 05/01/2023

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë", i ndryshuar



A2022052640833733762

*Akti noterial përbëhet nga 6 fletë



A2022052640833733762

KONTRATË SHITJE KUOTE KAPITALI

Sot, para meje Notere PERIAN B. BODINAKU, anëtare në Dhomën Kombëtare të Noterisë, Dega Vendore TIRANË, me zyrë në adresën Tiranë, Ç. TOPULLI, u paraqit personalisht:

SHITES:

Shoqëria TIRESR, regjistruar si person juridik në QKB (Qendra kombëtare e bizneseve) me numër unik identifikimi të subjektit NUIS M12413025K, me adresë Rruga Iliria, Ndertese Private, Zone Kadastrale Nr.1649, Numer Pasurie 28/26, përfaqësuar nga Administratori Arnold Meça, atësia Astrit, amësia Luftrije, shtetas Shqiptar, lindur në Mat dhe banues në Tiranë, me adresë Berti Beker; Nd. Privat; H. 1; Ap. 61/2; Njësia Administrative Nr. 7; Njesia Bashkiake Nr. 7; 1023; Tiranë, lindur më 18/04/1996, gjendja civile “beqar”, madhor, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të cilit u garantova me Leternjoftim ID nr. 032516063 dhe nr. personal J60418071N.

BLERES:

Blerta Nika, atësia Haki, amësia Vigjinie, shtetase Shqiptare, lindur në Cërrujë, Burrel dhe banuese në Tiranë, me adresë Halil Bega; Nd. 038; H. 0; Ap. 0; Njësia Administrative Nr. 4; Tiranë 4; 0000; Tiranë, lindur më 02/07/1987, gjendja civile “e martuar”, madhore, me zotësi të plotë juridike për të vepruar, për identitetin e të ciles u garantova me Leternjoftim ID nr. 032792360 dhe nr. personal I75702060G, .

Pasi verifikova statusin ligjor të palëve të sipërpërmendura, Unë Noterja konstatova se ato janë në përputhje të plotë me ligjin. Palët kontraktuese, me vullnetin e tyre të lirë e të plotë, duke iu përmbajtur dispozitave të Kodit Civil të Republikës së Shqipërisë neni 705 e vijues i tij, si dhe Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, bien dakord dhe kërkojnë nga Unë Noterja redaktimin e Kontratës së Shitjes të kuotave të kapitalit të Shoqërisë sipas kushteve dhe përcaktimeve ligjore të mëposhtme:

BAZA LIGJORE

- 3.1 Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë, nenet 705 dhe vijues të tij;
- 3.2 Ligji 9901, datë 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”;
- 3.3 Ligji nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”.

Une, Noteri, pasi verifikova dokumentacionin e paraqitur nga vete palet ose perfaqesuesit e tyre, vertetova se personat jane madhore dhe me zotesi te plote juridike e per te vepruar. Palet, me vullnetin e tyre te lire, kane kerkuar dhe kane rene dakord per hartimin e kesaj Kontrate, sipas afateve dhe kushteve te meposhtme:

KUSHTE PARAPRAKE

1. **Duke qene se “TIRES-R.” shpk.,** eshte person juridik shqiptar, regjistruar prane Qendres Kombetare te Biznesit me numer Nipt “M12413025K” me seli ne Tirane Kamez Valias Rruga Iliria ,Ndertese Private,Zone Kadestrale Nr.1649, Numer Pasurie 28/26 , (me poshte **Shoqeria**).



Shitesi Ortak i Shoqerise, i cili zoteron 100% te kapitalit te shoqerise i cili perbehet prej 1 kuote prej 100.000.00 leke(njeqind mije).

Duke qene se Shitesi ka per qellim t'i shese Bleresit dhe Bleresi ka per qellim t'i bleje Shitesit 100% (njqind) te kuotave qe Shitesi ka ne pronesi ne Shoqeri me cmimin e percaktuar me poshte, sipas modaliteteve te kesaj kontrate. ("Kuotat ne Shitje");

Palet bien dakord per sa me poshte vijon:

Neni 1
Perkufizime dhe Interpretime

1.1 Pervec kur konteksti kerkon ndryshe ose eshte parashikuar ndryshe ne kete Kontrate dhe shtojcat e saj, nese ka, fjalet me germa kapitale qe vijojne do te kene kuptimin e percaktuar ne kete Nen:

"Kontrata" do te thote kjo Kontrate per Shitblerjen e Kuotave, duke perfshire si pjese perberese te saj deklarimet e mesiperme dhe anekset e bashkangjitura, nenshkruar dhe shkëmbyer mes Bleresit dhe Shitesit.

"Data e Nenshkrimit" ka kuptimin e dates se nenshkrimit te kesaj Kontrate.

"Data e Mbylljes" Data ne te cilen Bleresi kryen pagesen e Cmimit te Blerjes sipas nenit 3.2.

"Barre" do te thote cdo hipoteke, detyrim, peng, garanci, e drejte zgjedhjeje, kufizim, e drejta e parablerjes, e drejta per t'u ofruar i pari ne blerje, e drejta ose interesi i nje pale te trete, barre ose interesa siguruese te cdo lloji, ose cdo lloj tjeter marreveshjeje preferenciale (duke perfshire, por pa u kufizuar ne transferimin e nje titulli ose te nje marreveshjeje kontrolluese) me efekte te ngjashme.

"Cmimi i Blerjes" do te thote cmimi qe Bleresi i paguan Shitesit per blerjen e Kuotave ne Shitje, sic percaktohet ne Nenin 3 te kesaj Kontrate dhe ne perputhje me mekanizmin pageses percaktuar aty.

"Kuotat ne Shitje" ose "Kuotat" do te thote 100 % (nje perqind) te Kuotave te kapitalit te Shoqerise, ne pronesi te Shitesit, te cilat i shiten Bleresit, sipas kesaj Kontrate.

1.2 Referencat ne kete Kontrate per nenet dhe shtojcat, nenkuptojne nenet dhe shtojcat e kesaj Kontrate (pervecse kur konteksti parashikon ndryshe). Shtojcat e kesaj Kontrate jane pjese perberese e saj.

1.3 Titujt ne kete Kontrate jane vendosur vetem per lehtesi referimi dhe nuk do ndikojne ne interpretimin e saj.



Neni 2
Shitja e Kuotave

2.1 Sipas kushteve dhe afateve te percaktuara ne kete Kontrate, Shitesi i shet Bleresit dhe Bleresi i blen Shitesit 100 % te Kuotave ne Daten e Nenshkrimit, te lira nga cdo Barre, me Cmimin e Blerjes per t'u paguar ne menyren e pershkruar ne nenin 3.

2.2 Bleresi fiton pronesine mbi Kuotat, dhe te gjitha te drejttat e lidhura me pronesine mbi Kuotat ne Shitje, ne Daten e Nenshkrimit te kesaj Kontrate. Bleresi i lind e drejta ne Daten e Nenshkrimit te kesaj Kontrate te regjistroje pronesine e tij mbi Kuotat ne Shitje duke paraqitur kete kontrate ne QKB, ne librat e Shoqerise dhe ne cdo organ tjetere kompetent.

Keshtu me nenshkrimin e kesaj kontrate bleresi behet ortak i vetem i shoqerise dhe do te zoteroje 100% te kuotave .

2.3. Bleresi ka te drejte qe me nenshkrimin e kontrates, te depozitoje dhe te regjistroje kete te fundit ne QKB, duke bere ne kete menyre kalimin e pronesise mbi kuotat ne shitje ne favor te Bleresit.

Neni 3
Cmimi i Blerjes

3.1 Cmimi i Blerjes per Kuotat ne Shitje eshte ne total ALL 100.000 (Njeqind mije) ("Cmimi i Blerjes").

3.2 Ky cmim perfshin dhe merr parasysh gjendjen aktuale ekonomike dhe pasurore te Shoqerise per te cilen Bleresi eshte ne dijeni, dhe ky i fundit deklarone se nuk ka asnje arsye kundershkrimi.

3.3 Cmimi i Blerjes do t'i paguhet Shitesit menjehere pas nenshkrimit te kesaj kontrate.

3.4 Paguesa do te behet ne llogarine e shitesit prane Credins Bank

3.5 Palet bien dakort qe cdo tarife bankare qe mund te behet i kerkueshem nga banka per transfertat e vlerave te mesiperme do te jete ne ngarkim te Shitesit.

3.6 Bleresi merr persiper te mbaje dhe te paguaje ne emer dhe per llogari te Shitesit tatimin perkates per cdo pjese te cmimit te paguar sipas parashikimeve te pikes 8/f te Ligjit nr. Nr. 8438, date 28.12.1998 „Per tatimin mbi te ardhurat“ i ndryshuar .

Neni 4
Mbyllja dhe Kushti i Mbylljes

4.1 Palet kane lidhur kete marreveshje duke qene te bindur se kjo kontrate eshte e detyrueshme per ta ne lidhje me te drejten e perfitimit te kuotave kundrejt cmimit te paguar dhe anasjalletas qe

keto kuotave kane vleren e percaktuar ne kete Kontrate te cilat jane likujduar teresisht ne momentin e nenshkrimit te kontrates, sipas mandatit bashkangjitur.

Neni 5
Deklarimet dhe Garancite e Shitesit

Shitesi me ane te kesaj Kontrate deklarone dhe garantone ne lidhje me Shoqerine si dhe me Transaksionin qe parashikohet ne kete Kontrate, per te gjitha ceshtjet qe vijoje, ne Daten e Nenshkrimit.

Shitesi deklarone dhe garantone Bleresin se Shoqeria ka depozituar ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi te gjitha deklarimet prane organeve tatimore dhe se nuk ka asnje detyrim deri ne daten e nenshkrimit te kesaj kontrate.

5.1. ORGANIZIMI



A2022052640833733762

Shoqeria eshte krijuar dhe themeluar rregullisht sipas ligjeve shqiptare, nuk eshte ne gjendje paafesie paguese apo ne falimentim, dhe ka fuqi te plote dhe kompetenca per te kryer aktivitetin e saj sic i kryen aktualisht.

5.2. AUTORIZIMI

Te gjitha aktet e parashikuara nga legjislacioni shqiptar ose statuti i Shoqerise qe duhet te ndermerren nga ose per llogari te Shitesit dhe qe autorizojne Shitesin te lidhe dhe te zbatoje kete Kontrate jane kryer rregullisht. Kjo Kontrate eshte nenshkruar dhe dorezuar rregullisht nga Shitesi dhe perben nje detyrim te vlefshem dhe ekzekutiv per Shitesin dhe qe duhet zbatuar prej tij, ne perputhje me kushtet dhe afatet e Kontrates.

5.3. PRONESIA

Shitesi eshte pronar dhe perfitues i vetem dhe i ligjshem i te gjitha Kuotave ne Shitje. Kuotat ne Shitje jane te lira dhe te çliruara nga çdo Barre e çfaredo lloji dhe Shitesi ka te gjitha te drejtat, kompetencat dhe autorizimin e plote per t'i shitur, per t'i kaluar, transferuar dhe dorezuar Kuotat ne Shitje ne perputhje me afatet e kesaj Kontrate.

Nuk ka asnje kontrate, marreveshje, ose detyrim qe krijon ose vendos ndonje Barre ne lidhje me Kuotat ne Shitje. Asnje person nuk pretendon se ka ndonje drejte mbi ndonje Barre lidhur me ndonje nga Kuotat ne Shitje.

Detyrimet e shoqerise ndaj te treteve jane ato te treguara ne bilancin e shoqerise per vitin e fundit financiar.

Pervec kesaj Kontrate, nuk ka asnje kontrate, marreveshje, ose detyrim qe parashikon krijimin, dhenien, emetimin, transferimin, riblerjen ose ripagimin e, ose dhenien e se drejtes nje personi (te kushtezuar ose jo) per te kerkuar dhenien, emetimin, transferimin, riblerjen ose ripagimin e ndonje kuote te kapitalit te Shoqerise (qe perfshin, por pa u kufizuar ne, nje preference - te drejten per te ofruar i pari -, ose te drejten e parablerjes ose kembim).

Neni 6

Te Drejtat dhe Detyrimet e Paleve

6.1 Bleresi gjate kesaj periudhe ka te drejte te ushtroje te drejten e votes ne lidhje me keto Kuota per marrjen e cdo vendimi te nevojshem per shoqerine si dhe per marrjen e vendimeve per shitjen tek te tretet te Kuotave qe do te kalojne ne pronesi te tij me nenshkrimin e kesaj kontrate.

Ne rast se cmimi i shitjes dhe detyrimet e tjera te parashikuara ne kete kontrate jane shlyer, Bleresi mund te marri vendime per shitjen e kuotave tek te tretet vetem me miratimin paraprak te Shitesit.

6.2 Bleresi gjate kesaj periudhe do te ushtroje te drejten e votes per keto kuota pa miratimin paraprak te pales shitese.

6.3 Palet bien dakort qe me nenshkrimin e kesaj kontrate, do te behet edhe transferimi i kuotave ne emer te Bleresit, pavaresisht afatit te pagesave, si dhe ky transferim do te rregjistrohet menjehere ne Qendren Kombetare te Biznesit.

Neni 7

Demshperblimi nga Shitesi dhe Bleresi

7.1 Shitesi duhet te demshperblej dhe te mbaj te pademtuar Bleresin dhe/ose Shoqerine per cdo Humbje tani dhe ne te ardhmen qe rrjedh ose varet direkt ose indirekt nga cdo veprim lidhur me fakte ose rrethana qe kane te bejne me titullin e pronesise mbi kuotat dhe te drejtat e tij mbi to, te krijuara apo qe kane ndodhur para Dates se Nenshkrimit, ose edhe pas kesaj date e qe prekin te drejtat e Shitesit sipas kesaj kontrate.

Neni 8



A2022052640833733762

Vlefshmeria e pavarur e dispozitave

8.1 Ne rast se nje klauzole ose nje dispozite sipas kesaj Kontrate eshte, per cfaredolloj arsyeje, e pavlefshme, e paligjshme, ose e pazbatueshme ne cfaredolloj aspekti, kjo pavlefshmeri, paligjshmeri dhe pazbatueshmeri e ketyre klauzolave ose dispozitave nuk do preke asnje klauzole ose dispozite te kesaj Kontrate dhe kjo Kontrate do te interpretohet dhe kuptohet sikur kjo klauzole ose dispozite, ne masen ne te cilen eshte e pavlefshme, e paligjshme, ose e pazbatueshme, nuk ka qene asnjehere pjese e Kontrates, megjithate, kjo pavlefshmeri, paligjshmeri, ose pazbatueshmeri nuk do te sjelle ndryshime materiale te Kontrates. Kjo do te thote, qe ne cdo rast, palet e kane shprehur vullnetin e tyre per te kryer transaksionin objekt i kesaj kontrate, pra shit-blerjen e kuotave ne shitje kundrejt cmimit te treguar ne kete kontrate dhe se marrin persiper te kryejne cdo veprim dhe ose te nenshkruajne cdo dokument te nevojshem per te realizuar qellimin qe i coi ata ne lidhje e kontrates ose shprehjen e vullnetit te tyre te plote ne lidhje me sa me siper.

Neni 9

Ligji i Zbatueshem

9.1 Kjo Kontrate do te rregullohet dhe interpretohet ne perputhje me legjislacionin shqiptar ne fuqi.
9.2. Cdo ndryshim i saj do te behet me shkrim dhe forma e thjeshte shkresore me nenshkrimin e te dy paleve eshte forma per te cilen palet kane rene dakort te kete vlere te plote per te vertetuar vullnetin e tyre.

9.3. Kjo kontrate dhe cdo ndryshimi saj ka fuqi te plote ndaj paleve dhe cdo trashegimtari te tyre duke perbere titull detyrimi per sa ajo paraqet ne te. Kjo kontrate nuk mund te transferohet apo ti kalohet ndonje te treti pa miratimin paraparak me shkrim te pales tjeter.

Neni 10

Zgjidhja e Mosmarreveshjeve

10.1 Cdo mosmarreveshje qe lind nga ose ne lidhje me kete Kontrate, duke perfshire por pa u kufizuar ne interpretimin, pavlefshmerine, mospermbushjen ose zgjidhjen e saj, si edhe mosmarreveshjet per mbushjen e hapesirave te Kontrates ose pershtatjen e saj me lindjen e rrethanave te reja, do t'i referohet per zgjidhje dhe do te zgjidhet nga gjykata kompetente shqiptare.

Neni 11

Menyra e Njoftimit

11.1 Pervec kur parashikohet ndryshe ne kete Kontrate, nje njoftim sipas kesaj Kontrate do te jete i vlefshem vetem nese eshte bere me shkrim e dorezohet personalisht ose me ane te postes elektronike.

Neni 12

Nenshkrimi

12.1 Kjo Kontrate eshte hartuar ne 4 (kater) kopje origjinale ne shqip me te njejten vlere ligjore dhe eshte nenshkruar nga Palet.

12.2 Shitesi dhe Bleresi bien dakord qe me kerkesen e pare te Pales tjeter dhe/ose Shoqerise, te nenshkruajne dhe te leshojne cdo dokument te nevojshem dhe ne pergjithesi te bejne cdo gje qe eshte e nevojshme qe transferimi i pronesise mbi Kuotat ne Shitje sipas kesaj Kontrate, te regjistrohet prane QKB-se, si edhe prane cdo autoriteti tjeter shqiptar, ne Daten e Nenshkrimit te Kontrates.

DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE



A2022052640833733762

13.1 Kontrata e Shitjes të kuotave të kapitalit u lexua nga unë Noterja me zë të lartë dhe në mënyrë të qartë në prani të Palëve kontraktuese; të cilët më deklaruan se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse shprehin vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht përpara meje Noteres.

13.2 Unë Noterja, verifikova identitetin e palëve nëpërmjet dokumenteve të identitetit dhe pasi e gjeta përmbajtjen e aktit noterial të mësipërm, në përputhje të plotë me nenin 62 të ligjit nr. 110, datë 20.12.2018 “Për Noterinë”, vërtetoj nënshkrimin e tyre.

13.3 Në zbatim të Ligjit 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave Personale”, unë Noterja deklaroj se do të ruaj dhe përpunoj të dhënat personale të subjekteve të kësaj kontrate, në mënyrë të drejtë dhe të ligjshme.

PALËT KONTRAKTUESE


BLERES

Blertha Nika

Blertha Nika 

SHITES

Arnold Meça

Arnold Meça 

NOTER
PERIAN B. BODINAKU




REZULTATET E KËRKIMIT

Numri i Rezultatit te Kerkimit: D-20230105132524
Data e Rezultatit te Kerkimit: 05.01.2023
Ora e Rezultatit te Kerkimit: 1:02:52PM
Lloji i Kerkimit:
Numri i Dokumentit: D-400-628-11063'
Referenca e Perdoriesit:

LISTA E PERSONAVE ME REZULTAT KERKIMI 0

ARNOLD ASTRIT MECA
TIRES-R SH.P.K.



Arhelo Bueser